



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME NR.3 E PUNËTORËVE TË QYTETIT**  
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, 2018

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Datë **22/11/2018**

**Nga:** Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit, Tiranë

**Për:** Operatorin ekonomik **Bojan Ajkoviq p.f, NIPT L62105042B**

**Adresa:** Rruga “Teodor Keko”, God.939, Tiranë

**Procedura e prokurimit:** Procedurë e hapur

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** Procedurë “Procedurë e hapur” me objekt **“Blerje dhe instalim soba me dru zjarri”**, kohëzgjatja e kontratës deri **40 (dyzet) ditë** nga nënshkrimi i kontratës.

**Numri i referencës së procedurës/lotit:** **REF-90185-10-16-2018**

**Fondi limit:** **8 332 000 (tetë milion e treqind e tridhjetë e dy mijë) lekë pa tvsh.**

**Burimi i Financimit:** Buxheti i Bashkisë Tiranë

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit:** 09.11.2018

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara si më poshtë;

1. Operatori ekonomik **“A.K.M Albanian Investment Group” Sh.p.k** me NIPT **L72230026K**, me adresë Rruga “Vaso Pasha”, Pall.IDS, Shk.1, kati 5, Tiranë, me ofertë **7 780 000 (shtatë milion e shtatëqind e tetëdhjetë mijë) Lekë pa Tvsh.**
2. Operatori ekonomik **“Bojan Ajkoviq” p.f** me NIPT **L62105042B** me seli në Adresë:

Rruga “Teodor Keko”, God.939, Tiranë me ofertë **7 897 200** (shtatë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e dyqind) **Lekë pa Tvsh.**

3. Operatori ekonomik **“Murati D” sh.p.k** me NIPT **K42003004T**, me adresë: Rruga e Kavajës, ish-Kombinati Ushqimor, me ofertë **7 680 800** (shtatë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë e tetëqind) **Lekë pa Tvsh.**

### **Skualifikohet;**

1. Operatori ekonomik **“A.K.M Albanian Investment Group” Sh.p.k** me NIPT **L72230026K** i cili nuk plotëson kriteret e veçanta sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit (DST) si më poshtë:

- Produkti i ofruar ATS 90-20 sipas katalogut të paraqitur nuk përputhet me specifikimet teknike të kërkuara në DST.
- Në dorëzimin e mostrave produkti ATS 90-20 është paraqitur me mangësi dhe i pa shoqëruar me aksesoret si tubat, bërrylat, rozeta sipas kërkesave të DST.
- Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për aksesoret e produktit për të vërtetuar përmbushjen e specifikimeve teknike sipas kërkesave të DST.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me nenin 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” si dhe kriterëve të pranimit kualifikimit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik **“A.K.M Albanian Investment Group” Sh.p.k me NIPT L72230026K** nuk është në përputhje me kërkesat e pranimit kualifikimit, **duke e shpallur ofertë të pavlefshme.**

2. Operatori ekonomik **“Murati D” sh.p.k** me NIPT **K42003004T** i cili nuk plotëson kriteret e veçanta sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit (DST) si më poshtë:

- Autorizimi i prodhuesit për distributorin zyrtar është paraqitur i papërkthyer dhe i pa noterizuar.
- Mungon deklarata e garancisë së prodhuesit për produktet e ofruara dhe është paraqitur vetëm deklaratë garancie nga ofertuesi dhe distributori zyrtar.
- Në dorëzimin e mostrave produkti është paraqitur me mangësi dhe i pa shoqëruar me aksesoret si tubat, bërrylat, rozeta sipas kërkesave të DST.
- Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për aksesoret e produktit për të vërtetuar përmbushjen e specifikimeve teknike sipas kërkesave të DST.
- Nuk plotëson pikën 5) të kapacitetit ekonomik dhe financiar duke paraqitur kontrata dhe fatura për produkte që nuk janë të ngjashme me produktet sipas kërkesave të DST.
- Nuk plotëson pikën c) të kapacitetit teknik duke mos paraqitur deklaratë konformiteti ose performance të prodhuesit.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me nenin 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” si dhe kriterëve të pranimit kualifikimit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik **“Murati D” sh.p.k me NIPT K42003004T** nuk është në përputhje me kërkesat e pranimit kualifikimit, **duke e shpallur ofertë të pavlefshme.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“Bojan Ajković” p.f** me NIPT **L62105042B** me seli në Adresën: Rruga “Teodor Keko”, God.939, Tiranë, se oferta e paraqitur për tenderin me objekt **“Blerje dhe instalim soba me dru zjarri”** me afat të lëvrimin deri **40 (dyzet) ditë** nga nënshkrimi i kontratës, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit, Tiranë, Rruga 5 maji, pranë Tregut të Medresesë**, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30(tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, procedura e prokurimit do të anulohet, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimet publike”.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 14/11/2018**

**Ankesa:** Nuk ka pasur.

